



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. 01/2021
Datë: 19.11.2021

Agjencia për Informim dhe Privatësi,

Në mbështetje të nenit 58 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 49 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, bazuar në kërkesën e parashtruar më datë 18.05.2021 nga Raiffeisen Bank Kosovo, për lejimin e autorizimit për transferimin e të dhënave, mori:

V E N D I M

1. Miratohen kërkesa për lejimin e autorizimit për transferimin e të dhënave personale në emër të Raiffeisen Bank Kosovo tek marrësi “Infocus” LLC, në shtetin e Ukrainës.
2. Obligohet Raiffeisen Bank Kosovo, që me rastin e transferimit të këtyre të dhënave të i përmbahet dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Obligohet Raiffeisen Bank Kosovo, që pas nënshkrimit të marrëveshjes me kompaninë “Infocus” LLC, sipas kushteve të parapara në draft-marrëveshje, të njëjtën t’ia paraqes Agjencisë.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (në tekstin e mëtejme Agjencia) në bazë të autorizimeve dhe përgjegjësi që burojnë nga Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 18.05.2021, ka pranuar një kërkesë nga Banka Raiffeisen Kosovo (në cilësinë e kontrolluesit) për lejimin e autorizimit për transferim të të dhënave personale në kompaninë “Infokus” LLC, me seli në shtetin e Ukrainës.

Agjencia mbanë një listë të vendeve dhe të organizatave ndërkombëtare ose një apo më shumë sektorë të specifikuar brenda tyre, për të cilat ajo konstaton se ato sigurojnë nivel të duhur të

mbrojtjes së të dhënave, në pajtim me këtë ligj, ashtu siç është paraparë në nenin 46 (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia me Vendim Nr. 04/2021, të datës 13.09.2021, ka caktuar se cilat vende dhe organizata ndërkombëtare konsiderohen se sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, pjesë e së cilën nuk është shteti i Ukrainës

Raiffeisen Bank Kosovo, me rastin e aplikimit për lejimin e transferimit, ka ofruar draft-marrëveshjen e përpunimit të të dhënave me kompaninë “Infocus” LLC, ku palët dakordohen të ndërmarrin mbrojtje adekuate në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve për transferimin e të dhënave personale të specifikuar me këtë draft-marrëveshje. Konkretisht në draft-marrëveshje janë paraparë obligimet dhe përgjegjësitë e palëve që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave si: masat teknike organizative (të bashkëlidhura në shtojcën 1), detyrimet e kontrolluesit dhe përpunuesit, sigurimi i cilësisë, komunikimi në rast të shkeljeve nga përpunuesi si dhe procedura e fshirjes dhe kthimi të dhënave personale tek kontrolluesi.

Raiffeisen Bank Kosovo, me këtë rast, ka ofruar dëshmi mbi masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale përmes certifikatave të pajtueshmërisë me standardet e sigurisë (PCI DSS) ku “Infocus” LLC është e pajisur me këto certifikata.

Në formularin për aprovimin e transferimit të të dhënave personale, kërkuesi ka dhënë detajet se cilat kategori të të dhënave do të transferohen për klientët e tyre (si emri, mbiemri, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja) dhe ka shpjeguar qëllimin e transferimit të të dhënave personale, që është ofrimi i shërbimeve këshilluese gjatë udhëtimeve (concierge service) për klientët e bankës që posedojnë kartela të tipit Visa Platinum. Gjithashtu, ka shpjeguar se në çdo rast të transferimit të të dhënave, fillimisht kërkohet nga klientët e bankës të japin pëlqimin dhe se ky shërbim ofrohet vetëm me kërkesë dhe pëlqim të klientit, me të cilin përmbushë edhe kushtin sipas nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2) të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ku thuhet se *“Agjencia mund të autorizojë transferimin apo publikimin e të dhënave personale në një shtet apo organizatë ndërkombëtare që nuk siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse përmbushet një apo më shumë nga kushtet e mëposhtme”*, në rastin konkret kur *“subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin dhe është i vetëdijshëm për pasojat e transferimit”*. Kohëzgjatja e përpunimit të tyre është e pacaktuar, deri në tërheqjen e pëlqimit nga ana e klientit, duke qenë në harmoni me të drejtën e subjektit për të kundërshtuar përpunimin në çdo kohë.

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi, si dhe studimit të përmbajtjes së tyre, si dhe në mbështetje të nenit 58 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 46 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia autorizon Raiffeisen Bank Kosovo, për transferimin e të dhënave personale në kompaninë “Infocus” LLC, duke përfshirë kategoritë e të dhënave, qëllimin e transferimit dhe masat mbrojtëse në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky vendim konsiderohet i vlefshëm në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes në mes të Raiffeisen Bank Kosovo dhe kompanisë “Infocus” LLC sipas kushteve të parapara në draft-marrëveshjen e ofruar në momentin e aplikimit për marrjen e autorizimit.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për kundërshtim në gjykatën kompetente për çështje administrative, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Krenare Sogojeva-Dermaku
_____(nënshkruar)_____
Komisionere për Informim dhe Privatësi

Vendimi i dërgohet:

- Raiffeisen Bank Kosovo
- Departamentit Ligjor të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë